



**Kuvendi i Komunës Klinë**

Nr prot. 06-3226/2024

Datë: 24.09/2024

*Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 06.09.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 20.09.2024 mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për transfer të mjeteve buxhetore brenda OB nga kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale (kodi -300), fondi burimor 10.
2. Nga programi Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470), nën-programi Bujqësia-Klinë (47018), kodi funksional (0421) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i kanaleve te ujitjes Budisalc-Jagode-Radulloç,Poterq-Dollovë”, kodi i projektit (54346), shuma prej 19,847.00 €,
3. Mjetet buxhetore si në piken 2 të këtij vendimi transferohen në:
  - Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh, Skender Rexhepi, Abedin Rexha, Mehmet Haxhaj, Haxhi Zeka”, kodi i projektit(54272) shuma 1,781.13 €.
  - Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dolle””, kodi i projektit(54280) shuma 8,175.87 €.
  - Programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730), nën-programin Shërbimet e shëndetësisë primare (74050) me kod funksional (0721) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti “Ndërtimi i nxemjes qendrore me pompa termike ne QKMF Kline“, kodi i projektit (54361), shuma 9,890.00 €.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

***Me këtë vendim njoftohen:***

***MAPL;***

***Kryetari i Komunes;***

***Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;***

***Zyra për Informim;***

***Arkivi.***



**Kryesues i Kuvendit  
Fadil Gashi**